REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM
TIRANË

Nr 783 Prot.

Tiranë, Tetor 2026

PLANI VJETOR
NJËSIA E ZHVILLIMIT

VITI SHKOLLOR 2026-2027

Përgjegjëse e Nj.Zh
Alma Caka

Drejtore
Elona Qehajaj

PËRMBAJTJA

1.1 Hyrje

1.2 **Baza ligjore** *3*

1.3 Përbërja e njësisë së zhvillimit ***4***

2.VEPRIMTARIA E NJËSISË GJATË VITIT MËSIMOR 2025-2026 ***5***

2.1 Arritje ***5***

2.2 Sfida ***6***

3.3.1 ***Objektivat e Njësisë*** *7*

- ***Objektivat për zhvillimin e vazhduar professional*** *8*
- ***Objektivat për zhvillimin e kurrikulës*** *8*
- ***Objektivat për krijimin e lidhjeve me biznesin*** *8*
- ***Objektivat për marketingun institucional*** *9*
- ***Objektivat për orientimin dhe keshillimin në karrierë te nxënësve*** *9*
- ***Objektivat për gjurmimin*** *9*
- ***Objektivat për hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore*** *9*

4. BURIME TË NEVOJSHME PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË ***10-13***

5. KOMENTE PËRMBYLLËSE ***13***

ANEKSE

HYRJE

Plani i njësisë së zhvillimit është hartuar nga koordinatorët e Njësisë së Zhvillimit gjatë periudhës shtator 2026

Ky plan vjetor mbështetet në një analizë të detajuar të arritjeve dhe sfidave të vitit 2025-2026 dhe në një sërë dokumentesh të dhënash dhe evidencash nga struktura të ndryshme të shkollës me qëllim koordinimin e përpjekjeve në mënyrë të tillë që të përmbushim objektivat e shkollës në mënyrë efektive dhe eficente. Për hartimin e këtij plani Njësia është mbështetur në prioritetet dhe objektivat vjetorë të shkollës duke mundësuar për nxënësit:përgatitje profesionale, përgatitje të personalitetit, zhvillim të karrierës dhe punësim.

Dokumenti është i ndarë në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë paraqitet një analizë e përmbushjes së objektivave të vitit SHKOLLOR 2024-2025 për njësinë dhe për secilën fushë koordinimi. Ndërsa në pjesën e dytë paraqitet në mënyrë të detajuar objektivat e njësisë dhe secilit prej koordinatorëve.

Për analizën e përmbushjes së objektivave jemi mbështetur në raportin vjetor të NJZH dhe raporteve vjetore të koordinatorëve të cilat janë konsultuar me drejtorinë e shkollës dhe drejtuesit e departamenteve.

BAZA LIGJORE

Njësia e Zhvillimit (NJZH) është struktura e brendshme e shkollës, e cila planifikon dhe realizon veprimtari zhvillimore në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të brendshme dhe rritjes së cilësisë. Ngritja e Njësisë në shkollat e arsimit profesional është bërë mbështetur në ligjin nr. 15/2017 për "*Arsimin e Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë"* dhe udhëzim nr. 759 i rishikuar datë 30.09.2024*: "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit* ". Në po të njëjtin udhëzim janë parashikuar edhe përbërja dhe detyrat e stafit të angazhuar në NJZH të cilat përcaktohen në Udhëzimet e Ministrit të Financ

PËRBËRJA E NJËSISË SË ZHVILLIMIT

- Alma Caka : Drejtuese e Njësisë së Zhvillimit /Koordinatore për sigurimin e cilësisë në shkollë.
- Alma Caka: Koordinatore për zhvillimin e kurrikulave.
- Edlira Lako: Koordinator për marrëdhëniet me biznesin.
- Dorina Gjonpali: Koordinatore për orientimin në karrierë.
- Driola Kadiu: Koordinatore për zhvillimin e vazhduar profesional të personelit mësimdhenies.
- Elisa Kita: Koordinatore për hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore.
- Klodian Tomani: Koordinatore për gjurmimin.
- Dajana Dule: Koordinatore e Marketingut

1. VEPRIMTARIA E NJËSISË GJATË VITIT SHKOLLOR 2025-2026

Arritjet e Njësisë së Zhvillimit për vitin shkollor 2025–2026

- Të gjitha planet e punës për funksionet e Njësisë së Zhvillimit janë hartuar në përputhje me objektivat dhe prioritetet e shkollës. Bashkëpunimi ndërmjet koordinatorëve, nën drejtimin e Përgjegjëses së NJZH-së, ka mundësuar koordinimin e veprimtarive dhe mbështetjen e proceseve të zhvillimit institucional.
- Aktivitetet e planifikuara janë realizuar në përputhje me objektivat e përcaktuara, duke u plotësuar edhe me veprimtari shtesë në përgjigje të udhëzimeve dhe prioriteteve të reja institucionale, si dhe të projekteve zhvillimore. Veprimtaritë kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për rolin dhe shërbimet e NJZH-së.
- Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse janë administruar dhe ruajtur në dosjet e koordinatorëve dhe në dokumentacionin e përbashkët të Njësisë së Zhvillimit, duke mbështetur proceset e monitorimit, raportimit dhe sigurimit të cilësisë.
- Garantimi i cilësisë dhe vetëvlerësimi: Është punuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, përfshirjen e aktorëve të interesuar dhe evidentimin e arritjeve dhe nevojave për përmirësim në fushat e veprimtarisë së shkollës. Pyetësorët e zhvilluar me nxënës, prindër, mësimdhënës dhe biznese kanë ndihmuar në vlerësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në identifikimin e prioriteteve për zhvillimin e mëtejshëm institucional.
- Një nga arritjet më të rëndësishme të vitit shkollor 2025–2026 ishte kalimi me sukses i procesit të akreditimit dhe certifikimi i shkollës, si rezultat i angazhimit të Drejtorisë, Njësisë së Zhvillimit, grupeve të vetëvlerësimit dhe gjithë stafit pedagogjik. Ky proces dëshmoi përkushtimin e institucionit ndaj përmbushjes së standardeve të cilësisë, dokumentimit të praktikave institucionale dhe përmirësimit të vazhdueshëm të arsimit dhe formimit profesional. Certifikimi përbën një arritje të rëndësishme institucionale dhe një bazë për konsolidimin e mëtejshëm të cilësisë së shërbimeve arsimore.
- Zhvillimi i vazhduar profesional i stafit: Janë mbështetur proceset e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, shkëmbimit të përvojave dhe përmirësimit të praktikave mësimore. Vëmendje i është kushtuar dokumentimit të trajnimeve, mbështetjes së mësimdhënësve dhe identifikimit të nevojave për zhvillim të mëtejshëm profesional.
- Zhvillimi i kurrikulës në nivel ofruesi: Është vijuar puna për përmirësimin dhe përshtatjen e kurrikulave me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e profesionit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit të kualifikimeve profesionale, përmirësimit të proceseve mësimore dhe forcimit të lidhjes ndërmjet teorisë dhe praktikës profesionale.
- Zgjerimi i bashkëpunimit me biznesin: Rrjeti i bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet partnere është zgjeruar, duke krijuar më shumë mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale, përfshirjen e bizneseve në veprimtaritë e shkollës dhe përshtatjen e formimit profesional me nevojat e tregut të punës.
- Gjurmimi dhe orientimi në karrierë: Janë zhvilluar veprimtari për orientimin e nxënësve drejt mundësive të punësimit dhe vijimit të mëtejshëm të formimit. Gjithashtu, është vijuar puna për gjurmimin e të diplomuarve, evidentimin e ecurisë së tyre pas përfundimit të shkollës dhe forcimin e lidhjes ndërmjet formimit profesional dhe punësimit.

- Zbatimi i projekteve zhvillimore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar: Pjesëmarrja në nisma dhe projekte zhvillimore ka krijuar mundësi për shkëmbimin e përvojave, përmirësimin e aftësive praktike të nxënësve, zhvillimin profesional të stafit dhe promovimin e shkollës. Bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj ka mbështetur proceset e modernizimit dhe ndërkombëtarizimit të institucionit.
- Marketingu institucional dhe promovimi i shkollës: Janë zhvilluar veprimtari promovuese për rritjen e dukshmërisë së shkollës, informimin e nxënësve të klasave të nënta dhe familjeve të tyre mbi kualifikimet e ofruara, si dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetin, bizneset dhe aktorët e tjerë të interesuar.
- Përmirësimi i proceseve të punës së NJZH-së: Veprimtaritë e realizuara kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet koordinatorëve, përmirësimin e administrimit të dokumentacionit dhe rritjen e rolit të Njësisë së Zhvillimit në planifikimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve arsimore dhe profesionale.

Qëllimi i njësisë së zhvillimit:

Në bazë të ligjit nr 15/2017 për "Arsimin e Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzim nr. 759 për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Njësia e Zhvillimit (NjZh) është struktura e brendshme e ofruesit të AFP-së, e cila planifikon dhe realizon veprimtari zhvillimore në mbështetje të ngritjes
së kapaciteteve të brendshme dhe rritjes së cilësisë.

Përbërja dhe detyrat e stafit të angazhuar në NjZh përcaktohen në Udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse Strategjia e punës së NjZh edhe koordinatorëve përkatës bazohet në parimet më të mira të menaxhimit dhe praktikat e sukseshme në Shqipëri dhe më tej.

NjZh mbështet mirëmenaxhimin e institucionit ofrues të AFP (IOAFP). Njësia funksionon në mbështetje të vizionit, misionit, objektivave planeve afatmesme dhe vjetore të institucionit dhe kontribuon në përmbushjen e tyre. Procesi i vetëvlerësimit ushqen dhe mbështetet nga veprimtaria e NjZh. Rezultatet e vetëvlerësimit nihmojnë në planifikimin e nismave për trajtimin e problemeve që mund të jenë dhe subjekt/fokus NjZh. Nga ana tjetër, veprimtaria e NjZh dokumentohet dhe shërben për të treguar progresin në fusha të caktuara.

Synimet

1. **Mbështetja e funksionimit të ofruesve të AFP**
   - Forcimi i rolit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) si institucione që gëzojnë autonomi funksionale dhe organizative.
   - Nxitja e bashkëpunimit me aktorët e sistemit arsimor, partnerët socialë dhe bizneset.
   - Përshtatja dhe zhvillimi i proceseve e instrumenteve të brendshme në mënyrë që ato të garantojnë përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit, duke synuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë.
2. **Rikonceptimi i imazhit dhe rolit të AFP**
   - Përforcimi i perceptimit të arsimit professional si aktorë të besueshëm dhe të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik e social.
   - Orientimi i qartë i shkollës drejt kërkesave të tregut të punës, si dhe përshtatja me zhvillimet bashkëkohore në fushën e ekonomisë, shkencës dhe teknologjisë.
   - Rritja e transparencës dhe e ndikimit të tyre në komunitet përmes marketingut institucional dhe marrëdhënieve të zgjeruara me bizneset.
3. **Mbështetja e institucionit në përgatitjen e nxënësve**
   - Sigurimi i aftësive bazë dhe të specializuara që kërkohen në tregun e punës, duke rritur punësueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e nxënësve.
   - Integrimi i komponentëve teorikë dhe praktikë në kurrikula, në përputhje me standardet e tregut dhe nevojat e sektorëve prioritarë.
   - Nxitja e kulturës së sipërmarrjes dhe inovacionit tek të rinjtë.
4. **Lehtësimi i përfshirjes së stafit në funksionet parësore dhe mbështetëse**
   - **Në funksionet parësore:**
     - Zhvillimi i aftësimit teorik dhe praktik përmes programeve të orientuara nga tregu.
     - Sigurimi i një procesi mësimor efektiv, efikas dhe me qasje të qendruar tek nxënësi/kursanti.
   - **Në funksionet mbështetëse:**
     - Përmirësimi i administrimit dhe menaxhimit institucional.
     - Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit mësimor dhe ndihmës.
     - Zgjerimi dhe thellimi i marrëdhënieve me bizneset për praktika profesionale dhe punësim.
     - Hartimi dhe menaxhimi i projekteve zhvillimore, me fokus në inovacion dhe rritje cilësie.
     - Fuqizimi i marketingut institucional dhe i orientimit në karrierë për nxënësit/kursantët.
     - Vendosja e mekanizmave për gjurmimin e nxënësve pas përfundimit të studimeve, si instrument për përmirësimin e programeve dhe rritjen e besueshmërisë.

1.1. Sfida

1. Konsolidimi i proceseve të garantimit të cilësisë pas akreditimit

Pas përfundimit me sukses të procesit të akreditimit dhe certifikimit të shkollës, sfida kryesore është ruajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i standardeve të arritura. Kjo kërkon monitorim sistematik të proceseve institucionale, zbatim të rekomandimeve për përmirësim, dokumentim të evidencave dhe angazhim të vazhdueshëm të të gjithë aktorëve të shkollës. Njësia e Zhvillimit duhet të vijojë të mbështesë proceset e vetëvlerësimit, analizën e të dhënave dhe hartimin e masave konkrete për përmirësim, në mënyrë që certifikimi të shoqërohet me zhvillim të qëndrueshëm të cilësisë së arsimit dhe formimit profesional.

2. Ndryshimet e koordinatorëve të Njësisë së Zhvillimit

Gjatë vitit shkollor 2025–2026, vazhdimësia e punës së Njësisë së Zhvillimit është mbështetur në përvojën e fituar nga koordinatorët në vitet e mëparshme. Ndryshimi i vetëm në përbërjen e koordinatorëve ka qenë në funksionin e marketingut institucional, ku koordinatorja e re ka pasur përvojë të mëparshme në këshillimin dhe orientimin në karrierë. Kjo ka lehtësuar përshtatjen me detyrat dhe vijimësinë e veprimtarive. Sfida mbetet ruajtja e një koordinimi të qëndrueshëm ndërmjet funksioneve, dokumentimi sistematik i proceseve dhe përcjellja e informacionit, me qëllim garantimin e vazhdimësisë dhe përmirësimit të punës së NJZH-së.

3. Zhvillimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve

Një nga sfidat kryesore mbetet sigurimi i pjesëmarrjes së vazhdueshme të mësimdhënësve në trajnimet dhe aktivitetet e zhvillimit profesional, për shkak të ngarkesës mësimore dhe vështirësive në organizimin e veprimtarive jashtë orarit të punës. Gjithashtu, mbetet e nevojshme zgjerimi i mundësive për trajnime praktike të realizuara në bashkëpunim me bizneset dhe specialistët e sektorëve përkatës. Për përballimin e këtyre sfidave, nevojitet identifikimi periodik i nevojave për trajnim, organizimi i veprimtarive të përshtatura me profilin profesional të mësimdhënësve dhe nxitja e shkëmbimit të përvojave përmes orëve të hapura dhe takimeve profesionale. Synimi është përmirësimi i vazhdueshëm i kompetencave të stafit dhe rritja e cilësisë së procesit mësimor.

4. Zhvillimi i kurrikulës në nivel ofruesi

Zhvillimi dhe përditësimi i kurrikulave mbetet një proces kompleks, që kërkon kohë, bashkëpunim ndërmjet departamenteve mësimore dhe përshtatje me ndryshimet në standardet profesionale dhe kërkesat e tregut të punës. Gjatë vitit 2025–2026, sfidë ka qenë rishikimi dhe zbatimi

i skelet-kurrikulave të reja, si dhe vijimi i përmirësimit të planeve, programeve dhe materialeve mësimore. Për adresimin e kësaj sfide, është e nevojshme të forcohet përfshirja e bizneseve në evidentimin e kompetencave të kërkuara, zhvillimin e moduleve praktike dhe përmirësimin e instrumenteve të vlerësimit. Synimi është krijimi i një kurrikule më fleksibël, të përditësuar dhe të orientuar drejt zhvillimit të kompetencave profesionale të nxënësve.

5. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve me biznesin

Megjithëse bashkëpunimi me bizneset është zgjeruar dhe gjatë vitit janë raportuar 32 marrëveshje bashkëpunimi dhe 35 biznese të reja partnere, sfidë mbetet sigurimi i një rrjeti të qëndrueshëm partnerësh për të gjitha drejtimet dhe kualifikimet, veçanërisht për Teknologjinë Ushqimore. Vështirësi paraqesin gjithashtu përshtatja e orareve të praktikave profesionale, organizimi i rotacionit të nxënësve dhe sigurimi i mundësive të barabarta për zhvillimin e praktikave në mjedise reale pune. Për përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi, nevojitet zgjerimi i bashkëpunimit me kompani të reja, forcimi i rolit të mentorëve dhe përfshirja më e madhe e bizneseve në vlerësimin e kompetencave të nxënësve. Qëllimi është rritja e cilësisë së praktikave dhe përmirësimi i përgatitjes së nxënësve për punësim.

6. Orientimi dhe këshillimi në karrierë i nxënësve

Një sfidë e vazhdueshme mbetet sigurimi i një orientimi sa më individual dhe efektiv për nxënësit, në përputhje me interesat, aftësitë dhe mundësitë reale të punësimit. Nevojitet forcimi i aftësive të nxënësve për hartimin e CV-së dhe letrës së motivimit, përgatitjen për intervista pune, komunikimin profesional dhe marrjen e vendimeve për karrierën. Gjithashtu, është e rëndësishme që orientimi të mbështetet në informacion të përditësuar mbi tregun e punës dhe mundësitë e vijimit të studimeve. Për këtë qëllim, nevojitet zgjerimi i bashkëpunimit me bizneset, ish-nxënësit dhe specialistët e karrierës, si dhe zhvillimi i veprimtarive praktike dhe këshillimit individual.

7. Hartimi dhe zbatimi i projekteve zhvillimore

Hartimi dhe zbatimi i projekteve zhvillimore kërkon angazhim të vazhdueshëm, koordinim ndërmjet mësimdhënësve, nxënësve dhe partnerëve, si dhe kapacitete për përgatitjen e aplikimeve cilësore. Ngarkesa mësimore dhe afatet e kufizuara mund të vështirësojnë përfshirjen e gjerë të stafit në këto procese. Gjatë vitit 2025–2026, janë zhvilluar iniciativa dhe aktivitete në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare, përfshirë veprimtari të lidhura me Erasmus+, si dhe janë paraqitur aplikime për projekte të tjera zhvillimore. Sfida mbetet sigurimi i vazhdimësisë së këtyre nismave, zgjerimi i partneriteteve dhe përfshirja më e madhe e nxënësve e mësimdhënësve në hartimin dhe zbatimin e projekteve. Synimi është rritja e mundësive për shkëmbim përvojash, zhvillim profesional dhe përmirësim të ofertës arsimore.

8. Zhvillimi i marketingut institucional

Gjatë vitit shkollor 2025–2026, marketingu institucional ka kontribuar në promovimin e ofertës arsimore dhe rritjen e dukshmërisë së shkollës përmes aktiviteteve prezantuese, publikimeve digjitale dhe bashkëpunimit me aktorët e komunitetit. Sfida mbetet sigurimi i një promovimi të

vazhdueshëm, të planifikuar dhe të matshëm, si dhe përfshirja aktive e nxënësve në prezantimin e përvojave dhe arritjeve të tyre profesionale. Nevojitet përditësimi i vazhdueshëm i materialeve promovuese, shfrytëzimi efektiv i rrjeteve sociale dhe mediave lokale, si dhe forcimi i bashkëpunimit me shkollat 9-vjeçare për informimin e nxënësve dhe prindërve. Synimi është rritja e interesit për kualifikimet e ofruara dhe konsolidimi i imazhit të shkollës si institucion cilësor i arsimit profesional.

9. Kryerja e gjurmimit në nivel ofruesi

Gjurmimi i të diplomuarve vijon të përballet me vështirësi që lidhen me ndryshimin e kontakteve, përgjigjet e kufizuara ndaj pyetësorëve dhe sigurimin e të dhënave të plota e të përditësuara për punësimin dhe vijimin e studimeve. Gjithashtu, mbetet sfidë analizimi i rezultateve sipas drejtimeve dhe kualifikimeve, në mënyrë që informacioni i mbledhur të përdoret për përmirësimin e ofertës arsimore dhe orientimin në karrierë. Për përmirësimin e procesit, nevojitet përditësimi periodik i bazës së të dhënave, përdorimi i instrumenteve digjitale, forcimi i kontakteve me ish-nxënësit dhe bashkëpunimi me bizneset për verifikimin e ecurisë së tyre profesionale. Synimi është sigurimi i të dhënave më të besueshme për vlerësimin e ndikimit të formimit profesional në punësimin e të diplomuarve.

1. OBJEKTIVAT 2026-2027

Gjatë këtij viti mësimor Njësia e zhvillimit ka parashikuar objektiva në nivel njësie dhe nivel koordinatorësh dhe aktivitete që synojnë në përmirësimin e cilësisë së punës së koordintorëvë dhe cilësisë së punës së institucionit tonë.

3.3.1 Objektivat e Sigurimit të Cilësisë

- **Objektivi 1:** Ruajtja e standardeve të akreditimit dhe përmbushja e rekomandimeve të lëna nga procesi i akreditimit
- **Objektivi 2:** Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për mësimdhënësit, nxënësit, bizneset dhe prindërit.

Objektivat në nivel koordinatorësh

Objektivat për gjurmimin

- **Objektivi 1:** Të realizohet gjurmimi i vazhdueshëm i ish-nxënësve maturantë të vitit shkollor 2025–2026, sipas drejtimeve dhe kualifikimeve profesionale, me qëllim evidentimin e nivelit të punësimit pas përfundimit të shkollimit.
- **Objektivi 2:** Të monitorohet progresi dhe orientimi profesional i nxënësve aktualë, veçanërisht i nxënësve të klasave të 12-ta, duke evidentuar pjesëmarrjen e tyre në praktikat profesionale dhe interesat për vazhdimin e studimeve ose përfshirjen në tregun e punës.
- **Objektivi 3:** Të realizohet gjurmimi i nxënësve të klasave të 11-ta, 12-ta dhe 13-ta, sipas drejtimeve dhe kualifikimeve profesionale, me fokus evidentimin e statusit të tyre të punësimit dhe përputhshmërisë së punësimit me profilin e shkollimit.
- **Objektivi 4:** Të ofrohet mbështetje dhe orientim për të gjithë nxënësit e interesuar për vazhdimin e studimeve pas përfundimit të arsimit të mesëm, duke i informuar dhe këshilluar mbi mundësitë e ndjekjes së programeve pas të mesme që ofrohen nga Shkolla e Mesme Profesionale “Hoteleri–Turizëm”.
- **Objektivi 5:** Të analizohen të dhënat e përftuara nga procesi i gjurmimit, me fokus evidentimin e numrit dhe përqindjes së ish-nxënësve të punësuar në profilin përkatës të shkollimit dhe jashtë tij, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të formimit profesional dhe identifikimin e nevojave për përmirësimin e ofertës arsimore.

Objektivat për marketingun institucional

- **Objektivi 1:** Zhvillimi Strategjik i Marketingut të Shkollës. Të hartojë dhe zbatojë strategjinë e marketingut të institucionit, në përputhje me misionin dhe vizionin e shkollës, me qëllim forcimin e imazhit dhe pozicionimit të saj si qendër ekselence në arsimin profesional në fushën e hotelerisë dhe turizmit.
- **Objektivi 2:** Promovimi dhe Komunikimi Efektiv i Shkollës. Të zhvillojë dhe të menaxhojë fushata promovuese dhe aktivitete komunikimi për të rritur vizibilitetin e shkollës, përmes mediave sociale, faqes zyrtare, pjesëmarrjes në panaire arsimore dhe organizimit të aktiviteteve prezantuese
- **Objektivi 3:** Nxitja e Partneriteteve dhe Bashkëpunimeve me Sektorin Profesional. Të identifikojë, zhvillojë dhe koordinojë marrëdhënie bashkëpunimi me biznese të fushës së hotelerisë dhe turizmit, me qëllim sigurimin e praktikave profesionale cilësore dhe krijimin e mundësive reale të punësimit për nxënësit.
- **Objektivi 4:** Edukimi dhe Motivimi i Nxënësve në Fushën e Marketingut dhe Sipërmarrjes. Të kontribuojë në zhvillimin e kompetencave profesionale të nxënësve në drejtim të marketingut, shërbimit dhe menaxhimit përmes ekipit të marketingut, aktiviteteve praktike, trajnimeve, konkurseve dhe projekteve të brendshme.

- **Objektivi 5:** Monitorimi, Raportimi dhe Analizimi i Perceptimit Publik. Të monitorojë dhe vlerësojë rezultatet e aktiviteteve të marketingut, të analizojë perceptimin publik dhe t'u raportojë drejtuesve të institucionit dhe Bordit Drejtues, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të strategjisë.

Objektivat për marrëdhëniet me biznesin

- **Objektivi 1:** Të sigurohet bashkëpunimi me bizneset për zhvillimin profesional të mësimdhënësve të moduleve profesionale, duke identifikuar biznese trajnuese dhe duke kontribuar në realizimin dhe vlerësimin e trajnimeve.
- **Objektivi 2:** Të sigurohet realizimi i praktikës profesionale në biznes për të gjitha kualifikimet që shkolla ofron, përmes zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të bizneseve partnere, vendosjes së nxënësve në praktikë dhe monitorimit të cilësisë.
- **Objektivi 3:** Të zgjerohet dhe formalizohet bashkëpunimi me bizneset përmes marrëveshjeve të reja, kontratave individuale të praktikës dhe vlerësimit periodik të marrëveshjeve ekzistuese.
- **Objektivi 4:** Të realizohet të paktën një cikël i plotë trajnimi për mentorët e bizneseve, duke përmirësuar metodologjinë e mentorimit, komunikimin me shkollën dhe procesin e vlerësimit të nxënësve.
- **Objektivi 5:** Të standardizohet mbledhja, dokumentimi dhe përdorimi i informacionit nga bizneset dhe grupet e interesit, duke siguruar gjurmueshmëri dhe raportim periodik.
- **Objektivi 6:** Të ndërtohet dhe zbatohet një sistem i strukturuar për monitorimin e cilësisë së praktikës profesionale dhe vlerësimin e kënaqësisë së bizneseve partnere.
- **Objektivi 7:** Të forcohet dialogu me bizneset për përshtatjen e ofertës dhe kurrikulës me nevojat e tregut të punës, si dhe për përfshirjen e profesionistëve të sektorit në aktivitetet e shkollës.
- **Objektivi 8:** Të mbështeten proceset e orientimit, provimeve të nivelit dhe organizimit të praktikës në bashkëpunim me bizneset, duke siguruar komunikim, koordinim dhe dokumentim të rregullt.

Objektivat për orientimin dhe këshillimin në karrierë

- **Objektivi 1:** Promovimi i ofertës arsimore, rekrutimi dhe orientimi fillestar i nxënësve të rinj.
- **Objektivi 2:** Integrimi i edukimit për karrierë dhe aftësive ndërkurrikulare në procesin mësimor.
- **Objektivi 3:** Zgjerimi i bashkëpunimit me bizneset partnere dhe fuqizimi i mësimit në vendin e punës.
- **Objektivi 4:** Këshillimi individual, aftësimi për punësim dhe orientimi i maturantëve (Klasat 11–13).
- **Objektivi 5:** Gjithëpërfshirja, mbështetja psiko-sociale dhe parandalimi i braktisjes shkollore. Plani vjetor
- **Objektivi 6:** Gjurmimi i të diplomuarve dhe përdorimi i të dhënave për përmirësimin e kurrikulës.

Objektivat për zhvillimin e kurrikulës

- **Objektivi 1:** Të përgatitet dhe të ndiqet aplikimi për hapjen e një kualifikimi të nivelit V KSHK dhe të mbështetet diversifikimi i ofertës mësimore sipas nevojave të tregut të punës gjatë vitit shkollor 2026–2027.
- **Objektivi 2:** Të integrohen aftësitë e buta, digjitale dhe të gjelbra në planet mësimdhënëse teorike dhe në modulet për të gjitha kualifikimet, duke trajnuar mbi 80% të mësimdhënësve.
- **Objektivi 3:** Të integrohen në planet lëndore metoda dhe teknologji innovative dhe të zbatohen e monitorohen gjatë vitit shkollor.
- **Objektivi 4:** Të përmirësohet struktura e monitorimit të cilësisë, të kapacitohen strukturat e brendshme për garantimin e cilësisë dhe të raportohet mbi zbatimin e kurrikulave.
- **Objektivi 5:** Të sigurohet që provimet e niveleve të realizohen sipas udhëzimeve dhe afateve, me instrumente të hartuara, komisione të mbështetura dhe nxënës të orientuar.
- **Objektivi 6:** Të zgjerohet bashkëpunimi me bizneset, universitetet dhe organizatat partnere për përshtatjen e kurrikulës me nevojat e tregut të punës dhe për trajnimin e mësimdhënësve.
- **Objektivi 7:** Të përmirësohet informimi dhe dokumentimi i mbledhjes së informacionit nga grupet e interesit dhe të monitorohet sistematikisht cilësia e praktikave profesionale në bashkëpunim me bizneset.
- **Objektivi 8:** Të mbështeten metodologjikisht mësimdhënësit gjatë gjithë vitit shkollor në hartimin e ditarit, të materialeve mësimore dhe të instrumenteve të vlerësimit.

Objektivat për hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore

- **Objektivi 1:** Thellimi dhe zbatimi i mëtejshëm i standardeve dhe metodologjisë së EHL në programet mësimore të shkollës, me synim rritjen e cilësisë së arsimit profesional, zhvillimin e kompetencave ndërkombëtare tek nxënësit dhe forcimin e profilit të shkollës si institucion model në rajon për edukimin në fushën e mikpritjes dhe turizmit.
- **Objektivi 2:** Vazhdimi i përfshirjes aktive të shkollës në projektet ERSAMUS + (Centers of Vocational Excellence (CoVE)), dhe Menaxhimi i projekteve Erasmus+ (thirrja ERASMUS-EDU-2026-CB-VET) në pritje të rezultatit dhe zbatimit te atyre që miratohen me qëllim fuqizimin e arsimit profesional në hoteleri-turizëm përmes bashkëpunimeve strategjike me partnerë evropianë.
- **Objektivi 3:** Rritja e nivelit të ndërkombëtarizimit të shkollës përmes partneriteteve dhe mobiliteteve të reja Erasmus+ (KA1) me institucione të arsimit profesional nga BE-ja (SEMIEDU) dhe projekteve qe financojne investime ne shkolle (RCF)
- **Objektivi 4:** Promovimi i barazisë gjinore dhe projekteve për gjithëpërfshirjen e nxënësve me forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e arsimit të lartë.

- **Objektivi 5:** Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në arsimin profesional përmes përfshirjes në projekte edukative duke integruar praktika të gjelbra në kuzhinë dhe mjediset e të nxënit.
- **Objektivi 6:** Planifikimi, koordinimi dhe zbatimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese, mbështetëse dhe ndërinstitucionale me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës, duke synuar identifikimin e hershëm të nxënësve në risk dhe përfshirjen aktive të prindërve.
- **Objektivi 7:** Identifikimi i burimeve të financimit, monitorimi dhe raportimi i zbatimit të projekteve tek drejtuesit e institucionit dhe Bordi Drejtues.

Objektivat për zhvillimin e vazhduar profesional

- **Objektivi 1:** Të identifikojë, analizojë dhe përcaktojë nevojat prioritare për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe t'i pasqyrojë ato në planifikimin vjetor të ZHVP-së. (Cikli gjithëvjetor i koordinatorit ZHVP)
- **Objektivi 2:** Të sigurojë përgatitjen dhe organizimin e materialeve mbështetëse për realizimin e veprimtarive të ZHVP-së, në përputhje me prioritetet e përcaktuara. (Cikli gjithëvjetor i koordinatorit ZHVP)
- **Objektivi 3:** Të zhvillojë veprimtari praktike për rritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në fushat prioritare të identifikuara (Prioriteti 2, objektivi 2.3.1 i zbatimit të planit vjetor 2026-2027)
- **Objektivi 4:** Të nxisë reflektimin profesional dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet mësimdhënësve përmes formave të thjeshta të bashkëpunimit professional (Rekomandimi 15 i zbatimit të planit vjetor 2026-2027)
- **Objektivi 5:** Të vlerësojë realizimin dhe efektivitetin e veprimtarive të ZHVP-së dhe të evidentojë rezultatet dhe nevojat për përmirësim. (Cikli gjithëvjetor i koordinatorit ZHVP)

PLANI I SIGURIMIT TË CILËSISË

Objektivi 1: Ruajtja e standardeve të akreditimit dhe përmbushja e rekomandimeve të lëna nga procesi i akreditimit				
Aktiviteti	**Tregues Performance**	**Personat Përgjegjës**	**Periudha**	**Dokumentim**
1. Analizimi i raportit të akreditimit dhe evidentimi i rekomandimeve të lëna për përmirësim.	Rekomandimet e identifikuara dhe të grupuara sipas fushave përkatëse të cilësisë.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët përkatës.	Shtator–Tetor 2026	Raporti i akreditimit; analiza e rekomandimeve; procesverbalet e takimeve.
2. Hartimi i një plani masash për adresimin e rekomandimeve të akreditimit, me përcaktimin e detyrave, përgjegjësive dhe afateve.	Plan masash i hartuar dhe i miratuar; përgjegjësi dhe afate të përcaktuara për çdo masë.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët dhe grupet përkatëse.	Tetor 2026	Plani i masave; dokumenti i miratimit; procesverbalet e mbledhjeve.
3. Informimi dhe ndërgjegjësimi i stafit për rëndësinë e ruajtjes së standardeve të akreditimit dhe zbatimit të rekomandimeve.	Stafi i informuar; rekomandimet dhe detyrat përkatëse të përcjella te strukturat përgjegjëse.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët.	Tetor–Nëntor 2026	Procesverbale mbledhjesh; njoftime; materiale informuese.
4. Monitorimi periodik i zbatimit të masave të përcaktuara në planin e veprimit.	Monitorime të realizuara sipas planifikimit; evidenca të progresit dhe problematikave të identifikuara.	Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët, grupet e vetëvlerësimit dhe personat përgjegjës për masat.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Formularë monitorimi; raporte periodike; evidenca të realizimit; procesverbale.
5. Kontrolli i dokumentacionit dhe evidencave që dëshmojnë përmbushjen e standardeve të cilësisë në fushat përkatëse.	Dokumentacion i plotë, i përditësuar dhe i organizuar sipas fushave dhe kritereve të cilësisë.	Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët dhe grupet e vetëvlerësimit.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Dosjet e dokumentacionit; evidencat e aktiviteteve; raportet; regjistrat përkatës.
6. Vlerësimi i progresit në përmbushjen e rekomandimeve dhe përcaktimi i masave korrigjuese për problematikat e evidentuara.	Analizë e progresit; problematika të identifikuara; masa korrigjuese dhe afate për përmirësim.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët dhe grupet përkatëse.	Janar–Shkurt 2027 dhe Qershor 2027	Raporte vlerësimi; procesverbale; plan masash të përditësuar.

7. Përgatitja e raportit përmbledhës mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe ruajtjen e standardeve të akreditimit.	Raport përmbledhës i hartuar, me arritjet, masat e realizuara, problematikat dhe rekomandimet për vijimësi.	Përgjegjësja e NJZH-së, në bashkëpunim me drejtorinë dhe koordinatorët.	Qershor 2027	Raporti vjetor i NJZH-së; raportet e monitorimit; evidencat e dokumentuara.

Objektivi 2: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për mësimdhënësit, nxënësit, bizneset dhe prindërit				
Aktiviteti	**Tregues Performance**	**Personat Përgjegjës**	**Periudha**	**Dokumentim**
1. Identifikimi i nevojave dhe pritshmërive të mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe bizneseve partnere për përmirësimin e shërbimeve të shkollës.	Nevojat dhe pritshmëritë e grupeve të interesit të evidentuara dhe të reflektuara në planifikimin e NJZH-së.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët përkatës.	Shtator–Tetor 2026	Pyetësorë; procesverbale; analiza të nevojave; dokumente planifikimi.
2. Hartimi dhe përditësimi i pyetësorëve për matjen e kënaqësisë së grupeve të interesit me shërbimet e ofruara nga shkolla.	Pyetësorë të hartuar ose të përditësuar për secilin grup interesi, sipas nevojave të identifikuara.	Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët dhe grupet përkatëse.	Tetor–Nëntor 2026	Modele pyetësorësh; dokumente elektronike; planifikimi i procesit të vlerësimit.
3. Realizimi i anketimit të mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe bizneseve partnere për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve.	Anketimi i grupeve të interesit i realizuar; numri i pjesëmarrësve dhe niveli i përgjigjeve të dokumentuara.	Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët dhe personat e ngarkuar.	Nëntor 2026–Shkurt 2027	Pyetësorët e plotësuar; databaza e përgjigjeve; evidenca të pjesëmarrjes.
4. Përpunimi dhe analizimi i rezultateve të pyetësorëve për evidentimin e nivelit të kënaqësisë, problematikave dhe fushave që kërkojnë përmirësim.	Analiza të përgatitura për secilin grup interesi; problematikat dhe nevojat për përmirësim të identifikuara.	Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët dhe grupet e vetëvlerësimit.	Shkurt–Mars 2027	Raporte analitike; tabela dhe grafikë; përmbledhje e rezultateve.
5. Hartimi i masave për përmirësimin e shërbimeve, bazuar në rezultatet e pyetësorëve dhe sugjerimet e grupeve të interesit.	Masa konkrete për përmirësim të përcaktuara, me përgjegjësi dhe afate zbatimi.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët dhe strukturat përkatëse.	Mars 2027	Plan masash; procesverbale takimesh; dokumente planifikimi.

6. Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe bizneset partnere për trajtimin e problematikave të evidentuara.	Takime dhe komunikime të realizuara; çështje të trajtuara dhe propozime të përcjella te strukturat përgjegjëse.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së, koordinatorët, kujdestarët e klasave dhe përfaqësuesit e bizneseve.	Gjatë gjithë vitit shkollor	Procesverbale; lista pjesëmarrjeje; njoftime; evidenca komunikimi dhe bashkëpunimi.
7. Vlerësimi i efektivitetit të masave të ndërmarra dhe përcaktimi i prioriteteve për përmirësimin e shërbimeve në vitin pasardhës.	Vlerësim i masave të zbatuara; evidentim i arritjeve dhe problematikave të mbetura; rekomandime për vijimësi.	Drejtoria, Përgjegjësja e NJZH-së dhe koordinatorët përkatës.	Maj–Qershor 2027	Raport përmbledhës; evidenca monitorimi; raporti vjetor i NJZH-së.

PLANI I GJURMIMIT

Objektivi 1. Të realizohet gjurmimi i vazhdueshëm i ish-nxënësve maturant 2025-2026.

Cikli gjithë vjetor i veprimtarisë së kordinatorit të gjurmimit.

Aktiviteti	Tregues Performance	Personat Përgjegjës	Periudha	Dokumentim
Krijimi i një databaze të ish-nxënësve	Databaza funksionale dhe e përditësuar.	Kordinatori i gjurmimit	Tetor 2026	Databaza elektronike
Përgatitja dhe shpërndarja e pyetësorëve	% e pyetësorëve të shpërndarë krahasuar me numrin total të ish-nxënësve	Kordinatori i gjurmimit	Nëntor 2026	Pyetësorët e shpërndarë
Mbledhja e pyetsorve nga mësuesit kujdestar.	Pyetsorët e mbledhur të plotësuar	Kordinatori i gjurmimit / mësues kujdestar.	Dhjetor 2026	Pyetsorët e mbledhur
Analiza e të dhënave dhe hartimi i raportit vjetor	Raport i përgatitur dhe i dorëzuar tek drejtoria dhe departamentet	Kordinatori i gjurmimit	Janar 2027	Raporti përfundimtar

Objektivi 2. Të monitorohet progresi dhe orientimi profesional i nxënësve aktualë.

Cikli gjithë vjetor i veprimtarisë së kordinatorit të gjurmimit.

Aktiviteti	Tregues Performance	Personat Përgjegjës	Periudha	Dokumentim
Mbledhja e të dhënave për frekuentimin, notat dhe praktikat profesionale	% e nxënësve të evidentuar në regjistër	Kordinatori i gjurmimit	Shkurt 2027	Regjistri i nxënësve

Organizimi i sesioneve informuese mbi orientimin në karrierë	Nr. i sesioneve të realizuara gjatë vitit	Kordinatori i gjurmimit / Kordinatori i karrierës	Shkurt 2027	Procesverbale sesioni, relacion,
Analizimi i kompetencave të fituara me kërkesat e tregut të punës	Raport analitik i dorëzuar	Kordinatori i gjurmimit / KMB	Mars 2027	Raportim tremujor, raporti vjetor.

Objektivi 3. Të realizohet gjurmimi i nxënësve të klasave të 11-ta, 12-ta dhe 13-ta. *Cikli gjithë vjetor i veprimtarisë së kordinatorit të gjurmimit.*				
Aktiviteti	**Tregues përformance**	**Personat përgjegjës**	**Periudha**	**Dokumentim**
Mbledhje e informacioneve për nxenesit e klasave te XI gjatë vitit mësimor 2026-2027	Realizimi i pyetësorëve për të gjithë nxënësit e klasave XI në lidhje me punësimin dhe ofertat e punësimit ne lidhje me arsimin profesional që po kryejnë, degën e studimit apo tjeter.	Kordinatori i gjurmimit Mësues kujdestarë	Mars 2027	Relacione të takimeve të grupit të punës. Analizë pyetësori Formular i mbledhjes së të dhënave.
Mbledhje e informacioneve për nxenesit e klasave te XII gjatë vitit mësimor 2026-2027	Realizimi i pyetësorëve për të gjithë nxënësit e klasave XII në lidhje me punësimin dhe ofertat e punësimit, ne profil apo jashte tij	Kordinatori i gjurmimit Mësues kujdestarë	Prill 2027	Relacione të takimeve të grupit të punës. Analizë pyetësori Formular i mbledhjes së të dhënave.

Mbledhje e informacioneve për nxënësit e klasave të XIII gjatë vitit mësimor 2026-2027	Realizimi i pyetësorëve për të gjithë nxënësit e klasave XIII në lidhje me punësimin dhe ofertat e punësimit gjate vitit mësimor 2026-2027	Kordinatori i gjurmimit Mësues kujdestarë	Maj 2027	Relacione të takimeve të grupit të punës. Analizë pyetësori Formular i mbledhjes së të dhënave.

Objektivi 4. Të ofrohet mbështetje dhe orientim për të gjithë nxënësit e interesuar për vazhdimin e studimeve pas përfundimit të arsimit të mesëm. *Cikli gjithë vjetor i veprimtarisë së kordinatorit të gjurmimit.*

Aktiviteti	Tregues përformance	Personat përgjegjës	Periudha	Dokumentim
Identifikimi i nxënësve të interesuar për vazhdimësi studimi	Nr. i nxënësve të evidentuar	Koordinatori i gjurmimit	Maj 2027	Regjistri i nxënësve të interesuar, relacion.
Këshillim individual dhe në grup për programet pas-mesme dhe kualifikimet	Numri i këshillimeve të realizuara	Koordinatori i gjurmimit / Koordinator i karrierës	Maj 2027	Procesverbale / lista pjesëmarrësish, relacion,
Ndjekja e progresit gjatë aplikimeve dhe regjistrimeve	Përqindja e nxënësve që aplikojnë dhe regjistrohen në programe pas të mesme	Kordinatori i gjurmimit	Qershor 2027	Procesverbale / lista rregjistrimesh, relacion,

Objektivi 5. Të analizohen të dhënat e përftuara nga procesi i gjurmimit. *Cikli gjithë vjetor i veprimtarisë së kordinatorit të gjurmimit.*

Aktiviteti	Tregues përformance	Personat përgjegjës	Periudha	Dokumentim

Përpunimi i të dhënave nga gjurmimi për të gjithë nxënësit e klasave të XI, XII, XIII, gjatë vitit shkollor 2026-2027 në lidhje me profilin e shkollës dhe vëndin e punës.	Analizimi i informacionit të mbledhur nëpërmjet formularëve të plotësuar nga nxënësit për realizimin me efektivitet të gjurmimit.	Kordinatori i gjurmimit Mesuesi kujdestar	Maj 2027	Procesverbal i shkruar Data Base Raporti vjetor
Reflektim për rezultatet e gjurmimit në bashkëpunim me kordinatorin e karrierës për ti drejtuar në AKPA për punësim, me prioritet grupet vurnerabël.	Raportimi i aktivitetit vjetor për realizimin e objektivave në drejtori dhe njësin e zhvillimit.	Kordinator i gjurmimit / Kordinatori i karrieres	Qershor 2027	Procesverbal i shkruar Data Base Raporti vjetor / relacion.
Raportimi i aktivitetit vjetor për realizimin e objektivave në drejtori dhe njësin e zhvillimit.	Raportimi i aktivitetit vjetor për realizimin e objektivave në drejtori dhe njësin e zhvillimit, sipas formatit të kërkuar.	Kordinatori i gjurmimit	Qershor 2027	Procesverbal i shkruar Data Base Raporti vjetor

PLANI I MARKETINGUT INSTITUCIONAL

Objektivi 1. Zhvillimi Strategjik i Marketingut të Shkollës

Të hartojë dhe zbatojë strategjinë e marketingut të institucionit, në përputhje me misionin dhe vizionin e shkollës, me qëllim forcimin e imazhit dhe pozicionimit të saj si qendër ekselence në arsimin profesional në fushën e hotelerisë dhe turizmit. ***Ref.(Cikli Gjithpërfshiërs,Analiza e Njësië)***

Aktiviteti	Tregues përformance	Personat përgjegjës	Periudha	Dokumentim	Burime (materiale e financiare)
1.1 Analiza e pozicionimit aktual të shkollës në tregun arsimor lokal dhe përcaktimi i objektivave strategjike të marketingut për vitin 2026–2027	Raport analitik mbi perceptimin e shkollës dhe dokument me objektivat strategjike të miratuara	KMB, Drejtori	Shtator – Tetor 2026	Raport analize, procesverbal takimi, dokument objektivash	Të dhëna regjistrimi dhe rezultatet e vitit paraardhës; kompjuter, printim. Financiare: buxheti i shkollës
1.2 Hartimi i planit të marketingut të shkollës dhe integrimi i tij në planin vjetor të ofruesit të AFP-së	Plan strategjik dhe plan vjetor marketingu i miratuar nga drejtoria	KMB, Drejtori, Financa, Përgjegjësi i NJZH	Shtator – Tetor 2026	Strategjia e marketingut, plani vjetor, miratimi zyrtar	Template i planit të marketingut; kompjuter. Financiare: plani financiar i shkollës
1.3 Planifikimi i pjesëmarrjes së kompanive në planin e Njësisë së Zhvillimit dhe dakordësimi i planit të marketingut me to	Plan i dakordësuar me kompanitë gjatë planifikimit të NJZH	KMB, Përgjegjësi i NJZH	Shtator – Tetor 2026	Procesverbal takimi, plani i NJZH i përditësuar	Elementët e planifikimit të eventit; sallë takimi
1.4 Ndarja me kompanitë e informacionit për shkollën dhe ofertën (katalogu i ofertës, rezultatet e gjurmimit)	Materiale informuese të ndara me të gjitha kompanitë e dakordësuara	KMB	Shtator – Tetor 2026	Katalogu i ofertës, email-e/dërgesa, raport gjurmimi	Template “Oferta e shkollës”, template “Raport gjurmimi”; printim. Financiare: buxheti i shkollës
1.5 Rishikimi i aktiviteteve të planit të marketingut dhe vendimi se në cilat aktivitete do të përfshihen bizneset	Rishikim i realizuar dhe listë e përditësuar e aktiviteteve me pjesëmarrjen e bizneseve	KMB, Drejtori	Janar 2027	Procesverbal rishikimi, plani i përditësuar	Plani vjetor i marketingut; sallë takimi

1.6 Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara sipas strategjisë vjetore të marketingut	Realizimi i të paktën 70% të aktiviteteve të parashikuara në plan	KMB, Stafi drejtues, Departamentet përkatëse	Tetor 2026 – Qershor 2027	Raporte mujore zbatimi, evidencë aktivitetesh, foto, lista pjesëmarrësish	Materiale promovuese, mjete TIK. Financiare: buxheti i shkollës dhe sponsorizime

Objektivi 2. Promovimi dhe Komunikimi Efektiv i Shkollës

Të zhvillojë dhe të menaxhojë fushata promovuese dhe aktivitete komunikimi për të rritur vizibilitetin e shkollës, përmes mediave sociale, faqes zyrtare, pjesëmarrjes në panaire arsimore dhe organizimit të aktiviteteve prezantuese. ***Ref.(Cikli Gjithpërfshiërs,Analiza e Njësië)***

Aktiviteti	**Tregues përformance**	**Personat përgjegjës**	**Periudha**	**Dokumentim**	**Burime (materiale e financiare)**
2.1 Hartimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve promovuese dhe të komunikimit	Kalendar i plotë i aktiviteteve i miratuar nga drejtoria	KMB, Drejtori	Shtator – Tetor 2026	Kalendari i aktiviteteve, procesverbal miratimi	Template i kalendarit të aktiviteteve marketing
2.2 Menaxhimi i mediave sociale dhe faqes zyrtare të shkollës sipas kalendarit të postimeve	Kalendar postimesh i zbatuar; postime të rregullta gjatë vitit	Drejtori, Ekipi i marketingut, KMB	Gjatë gjithë vitit	Kalendari i postimeve, screenshot-e postimesh, raporte	Shembuj postimesh dhe kalendari model; pajisje TIK (telefon, kamerë). Financiare: buxheti i shkollës
2.3 Menaxhimi i marrëdhënieve me mediat lokale	Të paktën 3 paraqitje/njoftime në media lokale gjatë vitit	Drejtori, Ekipi i marketingut, KMB	Gjatë gjithë vitit	Njoftime për shtyp, lidhje/kopje të publikimeve	Lista kontaktesh e medias; komunikata për shtyp
